



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2020:086363  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05439577

Rev.nr.75/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Nenad Lazic dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: N. Sh. nga I, rr. "...", nr...., kundër të paditurës: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, me seli në Prishtinë, për kompensimin e diferencës së pagës, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2404/2021, të datës 20.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurës: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2404/2021, të datës 20.12.2022.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog C.nr.633/2020, të datës 21.12.2020, është vendosur: I. Aprovohet në tërësi si e bazuar, kërkesëpadija e paditësit N. Sh. nga I. rr. "R.", nr.... . II. Anullohet aktvendim i të paditurës: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Nr...., i datës..., dhe detyrohet e paditura Posta Telekomunikacioni i Kosovës në Prishtinë, që paditësit N. Sh. nga I, në emër të kompensimit të diferencës së pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës ... dhe ..., për periudhë kohore ... gjerë më datë..., t'ia paguaj shumën totale në bruto pagesë - diferencës me pak të paguar në shumë prej ... €, nga e cila shumë ndalet në burim kontributi pensionale në shumë prej ... € dhe tatimi në burim ... €, nga rezulton diferenca e pagës neto më pak e paguar në shumë prej ... €, obligohet e paditura që ta përfundojë edhe shumën prej ... € në fondin e trustit pensionale, nga llogaria e punëdhënësit në të mirë të

llogarisë së paditësit, në emër të kamatës, nga data ... gjerë më datë ... shumën prej ... €, si dhe detyrohet e paditura që paditësit prestimin nga pika I, e dispozitivi të këtij aktgjykimi t'i përmbush në afat prej 7 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2404/2021, të datës 20.12.2022, është vendosur që të: Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurës Telekom i Kosovës, Sh.A. (ish Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës) Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.633/2020, i datës 21.12.2020, vërtetohet.

Kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet i bazuar revizioni i të paditurës, ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac.nr.2404/21, i datës 20.12.2023, dhe ai i Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog. C.nr.633/20, i datës 21.12.2020, ashtu që padia dhe kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi e pabazuar, ose, të prishen të dy aktgjykimet e instancave me të ulëta dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në revizionin e të paditurës nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë... , në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensimin e diferencës së pagës, duke kërkuar më saktësisht si në kërkesëpadi, të precizuar në seancën e datës 27.01.2017.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë se paditësit kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.633/2020, të datës 21.12.2020, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin.

Në arsyetim të aktgjykimin gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: kontratën e punës me nr.... të datës... , e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, aktvendimin me nr.... të datës... , mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale, pasqyrë e të ardhurave personale për paditësin me shenjën, ID: .. të datës... , për të ardhurat personale për muajin janar deri në muajin mars të... , dokumentin zyrtar të paditurës PTK, mbi lartësinë e pagesave sipas gradave, përlllogaritjen e diferencës bashkë me interesin për periudhën kohore... , deri më datë... , referencën nga ministria e zhvillimit ekonomik të datës... , me nr protokollin..., ekspertizën financiare të punuar nga eksperti gjyqësor U. S. nga P. e përpiluar më datë..., plotësimi i ekspertizës financiare nga eksperti i njëjtë pranuar në gjykatë më datë....

Ka shtuar se sipas nenit 3 të kontratës së punës Nr. ... shprehimisht është paraparë se të punësuarit i caktohet paga bazë për punën e kryer për punëdhënësin, në lartësi të gradës ..., sipas vendimit

të bordit të përkohshëm të drejtorëve të PTK-së Nr. ... të datës... , së paku një herë në muaj dhe bëhet e pagueshme me ose para datës 10 të muajt pasardhës muajin e mëparshëm. Pasi gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e cekura me lartë konstatoi dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar sepse paditësi dhe e paditura raportin e tyre të drejtat dhe detyrat e tyre punëdhënës - punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë në të shkruar, duke përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke, gjykata ka konstatuar se kontrata e punës është lidhur në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të cekura me lartë, se kushtet e kontratës së punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës duke marrë për bazë edhe lartësinë e pagës-përkatësisht gradës së të ardhurave personale sipas të cilës do të paguhet paga e punëtorit për punën e kryer është në pajtim të plotë me dispozita ligjore të Ligjit të Punës. Gjykata konstaton se marrëdhënia e punës është marrëdhënie juridike - kontraktuese ku palët me rastin e lidhjes së një kontrate të tillë duhet të respektojnë kushtet e kontratës si tërësi për çka në rastin konkret gjykata konstaton se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës është lidhur duke u respektuar të gjitha kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës siç janë aftësia punese e palëve kontraktuese, pajtimi i vullnetit të palëve, lënda - objekti i kontratës dhe baza e kontratës. Gjykata ka vlerësuar se është parim i së drejtës se palët me vullnetin e tyre të lirë të shprehur apo me veprime konkludente mund të krijojnë raporte juridike gjegjësisht marrëdhënie juridike, palët me vullnetin e tyre të shprehur apo me veprime konkludente mund të ndryshojnë apo të shuajnë një marrëdhënie juridike - raport juridik. Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar duke marrë për bazë pjesërisht edhe parashtrësën e datës... , vendimin - procesverbalin e datës ... dhe procesverbalin me nr.... të datës... , në bazë të të cilave gjykata ka konstatuar se kërkesa e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Zhvillimit Ekonomik, ka qenë ulja e shpenzimeve operative për personelin e të paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-së, por kërkesa nuk ka qenë ulja e gradës së të ardhurave personale dhe si e tillë nuk ka mundur të bëhet në mënyrë të njëanshme siç e ka bërë e paditura në rastin konkret për çka edhe vendimi i kontestuar është i pa drejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadiës ka shtuar se për zvogëlimin e gradës së punës nga 10 në 9, kjo gjykatë ka nxjerrë ekspertizën financiare të cilën e ka punuar eksperti financiar U. S. më datë..., me të cilën ekspertizë është përlllogaritur diferenca e pagës, trustit pensional në mes të gradës ... dhe ... për periudhën kohore..., gjer më..., më datë..., ka bërë plotësimin e ekspertizës, duke përlllogaritur diferencën e pagave për periudhën kohore ...deri më datë..., ku gjykata ka gjetur së paditësi ishte dëmtuar në pagë në shumën totale në bruto pagesë - diferencë më pak të paguar në shumën prej ... €, nga e cila shumë ndalet në burim kontributi pensional në shumë prej ... €, dhe tatimi në burim ...€, nga rezulton se diferenca e pagës neto më pak e paguar në shumë prej ... €, në fondin e trustit pensional, nga llogaria e punëdhënësit në të mirë të llogarisë së paditësit, dhe kamata e përlllogaritur mbi bazën e diferencës neto pagesës më pak të paguar, nga data ... gjer më datë ... shumën prej ... €, ku gjykata ekspertizës financiare të datës ...e cila ishte e plotësuar me parashtrësën e datës..., ja falë besimin e plotë, pasi që është punuar në mënyrë profesionale dhe është në harmoni me provat në shkresat e lëndë, me çka gjykata duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike, vendosi që të aprovoi lartësinë e kërkesëpadiës si në dispozitiv të aktgjykimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 10, 11, 55, 56 të Ligjit të Punës, nenit 7 dhe 319 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Vendimin për kamatën e ka mbështetur në nenin 186, lidhur me nenin 277 të LMD-së, (1978).Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 463 paragrafi 2 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.2404/2021, të datës 20.12.2022, ka vendosur që të refuzoj ankesën e palës së paditur, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të atakuar me ankesë dhe as me shkelje nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, për arsye se dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e titullit përmbarimor dhe i përshtatshëm për përmbarim, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet

ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se:

Më nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se: “ Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshinë elementet e përcaktuara sipas neni 11 të këtij ligji ”, me neni 10 paragrafi 2, pika 2.1 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Kontrata e punës mundë të lidhet për një periudhë të pacaktuar ”, me nenin 10 paragrafi 3 të këtij ligji përcaktohet se: “ Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar ”, me nenin 10 paragrafi 5 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se 10 (dhjetë) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore ”.

Me nenin 11 të Ligjit të Punës përcaktohet se: “ Çfarë duhet të përmbaj kontrata e punës ”.

Me nenin 11 paragrafi 1 pika 1.8 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër ”.

Me nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat e tjera, i punësuar i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohen e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës ”.

Me nenin 56 të këtij ligji, janë përcaktuar të drejtat në pagesë shtesë të punëtorit në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe kontratën e punës.

Me nenin 3.1 dhe 3.2 të kontratës së punës Nr. ... të datës... , është përcaktuar se: 3.1. I punësuar do të përfitoj një pagë të përcaktuar nga grada 10, sipas vendimit të bordit të përkohshëm të Drejtorëve të PTK-së, nr.... , të datës ...dhe ... pagesa do të bëhet një herë në muaj dhe bëhet e pagueshme me ose para datë 10 të muajit pasardhës për muajin e mëparshëm.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale dhe e se e paditura ka për detyrim që paditësit ti bëjë kompensimin e diferencës së pagës në shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, sepse sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 10 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të paditurës, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të paditurës për vitin ... duhet të jetë jo më shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditësit, pasi që në rekomandimin e Ministrisë, nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajizuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve, duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet e të paditurës janë të pabazuara. Në këtë rast nuk ka prova se e paditura ka bërë ndërhyrjen në aktet

normative të saja lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta, drejt kanë aplikuar të drejtën materiale përkatësisht nëse i referohemi nenit 55 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, me të cilin është përcaktuar se: “ I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ”. Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Meqenëse e paditura me asnjë provë të vetme, nuk e ka argumentuar se ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike edhe kjo gjykatë erdhi në përfundim se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit për kompensimin e diferencës së pagës nga grada ... në ... , në shumën si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe gjen mbështetje edhe në nenin 262 paragraf 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se: “ Kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve, është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbush detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi sikur është përmbajtja e tij ”, dhe si rezultat i kësaj meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, e paditura ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse e paditura e ka cilësinë e debitorit.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.75/24, datë 11.03.2024

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi